



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.Shk.II.nr.181/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit “Kompania e Sigurimeve SIGAL Uniqa Group Austria sh.p.k me seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti” nr.9, kundër debitorit Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, që sipas autorizimit përfaqësohet nga D.GJ., zyrtar ligjor tek debitori, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.638/22 të datës 06.11.2023, me datë 04.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit SIGAL Uniqa Group Austria sh.p.k ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.638/22 të datës 06.11.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.638/22 të datës 06.11.2023, në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 145/21 i datës 25.01.2021, i lejuar nga Përmbarues Privat Isa Gacaferi, është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.638/22 të datës 06.11.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori SIGAL Uniqa Group Austria sh.p.k, ka paraqitur propozimin për përmbarim në bazë të dokumenteve: Fatura nr. 60106/06, dt. 05.06.2017, shuma 240.72 EUR; - Fatura nr.05814 dt.07.02.2017, shuma 2,522.84 EUR; - Fatura nr. 058141, dt. 07.02.2017, shuma 2522.84 EUR; Fatura nr. 058138/02, dt. 06.02.2017, shuma 153.40 EUR; Fatura nr. 058138-b/02, dt. 06.02.2017, shuma 55.22 EUR; Fatura nr. 058194, dt. 27.02.2017, shuma 247.80 EUR; Fatura nr. 0061456/8, dt. 23.08.2017, shuma 991.20 EUR; Fatura nr. 058138/02, dt. 06.02.2017, shuma 153.40 EUR; Fatura nr. 58134-A/02, dt. 01.02.2017, shuma 552.24 EUR; Fatura nr. 58134/02, dt. 01.02.2017, shuma 816.56 EUR; Fatura nr. 058138/02, dt. 06.02.2017, shuma 153.40 EUR; - Fatura nr. 0060113, dt. 20.06.2017, shuma 1269.68 EUR; Fatura nr. 65728/02, dt. 06.02.2018, shuma 198.24 EUR; Fatura nr. 068256-1, dt. 20.06.2018, shuma 148.68 EUR; Fatura nr. 0065839/5, dt. 20.03.2018, shuma 778.80 EUR; Fatura nr. 0073739, dt. 12.07.2018, shuma 1510.40 EUR; Fatura nr. 068256, dt. 05.06.2018, shuma 240.72 EUR; Fatura nr. 069564/07, dt. 12.07.2018, shuma 2046.12 EUR; Fatura nr. 069564, dt. 12.07.2018, shuma 1312.16 EUR; Fatura nr. 0070144, dt. 29.10.2018, shuma 967.60 EUR; Fatura nr. 0070144/11, dt. 01.11.2018, shuma 359.90 EUR; Fatura nr. 0073741/10, dt. 17.10.2019, shuma 247.80 EUR; Fatura nr. 0073781/V, dt. 11.03.2019, shuma 247.80 EUR; Fatura nr. 0073781/D, dt. 07.03.2019, shuma 185.85 EUR; Fatura nr. 0073781/2, dt. 04.02.2019, shuma 247.80 EUR; Fatura nr. 0073781, dt. 04.02.2019, shuma 198.24 EUR; Fatura nr. 0073676/1, dt. 28.06.2019, shuma 138.77 EUR; Fatura nr.0074787, dt. 05.11.2019, shuma 607.70 EUR; Fatura nr. 0074787/A, dt. 05.11.2019, shuma 719.80 EUR; Fatura nr. 0073781/A, dt. 07.02.2019, shuma 3117.56 EUR; Fatura nr. 0073684/2, dt. 23.08.2019, shuma 535.72 EUR; Fatura nr. 0073684/1, dt. 13.08.2019, shuma 2049.66 EUR; Fatura nr. 0073684, dt. 02.08.2019, shuma 240.72 EUR; Fatura nr. 0074787, dt. 05.11.2019, shuma 1327.50 EUR; Fatura nr. 0074922, dt. 12.02.2020, shuma 3183.55 EUR; Fatura nr. 0074922-b, dt. 24.02.2020, shuma 466.20 EUR; Fatura nr. 0074922-A, dt. 21.02.2020, shuma 233.10EUR; Fatura nr. 0074922-C, dt. 27.02.2020, shuma 198.24 EUR; Fatura nr. 0074874, dt. 13.11.2020, shuma 22.31 EUR, ashtu që është detyruar debitori, që në emër të borxhit të papaguar nga faturat e lartcekura, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 29,210.24 EUR (njëzet e nëntë mijë e dyqind e dhjetë euro e njëzet e katër euro cent) me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e ushtrimit të propozimit për përmbarim deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbarimit, me arsyetimin se faturat te cilat i janë bashkangjitur propozimit përmbarimit nuk janë dokumente përmbaruese dhe si të tilla nuk paraqesin titull ekzekutiv, ashtu siç parashihet ne nenin 29 te LPP-së kjo për faktin se te njëjtat janë te njëanshme dhe nuk janë te pranuar dhe te nënshkuara nga personat e autorizuar. Kreditori ka dështuar qe te bashkangjes provat e nevojshme mbi të cilat e bazon këtë propozim për përmbarim pasi qe i njëjti nuk ka bashkangjitur asnjë kontrate me te cilën tregohet raporti juridik i kreditorit dhe debitorit, pasi pa kontrate faturimi është i kundërligjshëm dhe ne kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik, andaj burim i faturave është i panjohur. Qe urdhri për lejimin e përmbarimit është i kundërligjshëm, i paqartë dhe i pabazuar vërtetohet edhe me vete faturat te cilat i janë bashkangjitur këtij propozimi, kjo për faktin se fatura me nr. 058141 e datës 07.02.2017 ne shumen prej 2522.84 €, është kërkuar dy here

ne propozim përmbarim, kjo faturë është identike ne nr. te faturës, ne përshkrim dhe ne date, mirëpo ne propozim është kërkuar dy here dhe atë: fatura me nr. 05814 e datës 07.02.2017 dhe fatura me nr.. 058141 e datës 07.02.2017, po ashtu edhe fatura me nr. 058138/02 e datës 06.02.2017 ne shume prej 153.40 € janë kërkuar nga kreditori dy herë ne propozim përmbarim dhe nga kjo rezulton se propozim përmbarimi është i kundërligjshëm, pasi qe ka dhe të tjera fatura të cilat në propozim janë kërkuar dy herë, për me tepër ndër te tjera ne fatura ka edhe ndërhyrje fizike të shkruara me dorë ne pjesën e te hollave që ne vazhdimësi e bën edhe me te paqartë dhe te kundërligjshëm urdhrin për përmbarim. Ka shtuar se edhe nëse do të ishin të bazuara pretendimet e kreditorit, dymbëdhjetë faturat mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi janë përfshirë në parashkrim konform neni 353 të LMD-së dhe atë Fatura nr. 60106/06 e datës 05.06.2017; Fatura nr. 05814 e datës 07.02.2017; Fatura nr. 058141 e datës 07.02.2017; • Fatura nr.058138/02 e datës 06.02.2017; Fatura nr.058138-b/02 e datës 06.02.2017; Fatura nr. 058194 e datës 27.02.2017; Fatura nr.006145/8 e datës 23.08.2017; Fatura nr.0583/02 e datës 06.02.2017; Fatura nr.05134-A/02 e datës 01.02.2017; Fatura nr.58134/02 e datës 01.02.2017; Fatura nr.058138/02 e datës 06.02.2017 dhe Fatura nr. 0060113 e datës 20.06.2017.

Kreditore në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e ngritura nga debitori, kjo për faktin se i njëjti nuk ka mbështetur prapësimin e tij në asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPP-së, ë në anën tjetër debitori në asnjë pikë të prapësimit nuk e ka kontestuar faturën e as pranimin e faturës si dokument i pambarueshëm nga neni 29 i LPP-së. Ka shtuar se kreditore, si operator ekonomik dhe debitori si autoritet kontraktues kanë nënshkruar kontratën publike kornizë me nr. 616 16 156 221 e datës 30.01.2017 në afat prej tridhjetë e gjashtë (36) muajsh, ashtu që kreditore i ka siguruar mjetet motorike të debitorit dhe e kishte furnizuar debitorin me faturat e bashkangjitura në propozim. Ka shtuar se nuk qëndron pretendimi se kemi të bëjmë me parashkrim, pasi që afati i kontratës është 36 muaj duke filluar nga lidhja e kontratës.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.638/22 të datës 06.11.2023, ku në dispozitiv të aktvendimit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 145/21 i datës 25.01.2021, i lejuar nga Përmbarues Privat Isa Gacaferi, është anuluar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata erdhi në përfundim se faturat nr. 60106/06, nr. 05814, nr. 058141, nr.058138/02, nr.058138-b/02; nr. 058194, nr.006145/8, nr.0583/02, nr.05134-A/02, nr.58134/02, nr.058138/ dhe fatura nr. 0060113 janë lëshuar që të gjitha gjatë vitit kalendarik 2017, andaj, borxhi që rrjedh nga faturat e lartcekura është përfshirë në parashkrim sepse propozimi për përmbarim lidhur me këto fatura është paraqitur me datë 22.01.2021, mbi katër (4) vite nga arritja e tyre për pagesë, pra jashtë afatit tre (3) vjeçar të parashkrimit nga neni 355.1 i LMD-së.

Ndërsa, Gjykata gjeti se faturat nr. 65728/02, dt. 06.02.2018, Fatura nr. 068256-1, dt. 20.06.2018; Fatura nr. 0065839/5, dt. 20.03.2018; Fatura nr. 0073739, dt. 12.07.2018; Fatura nr. 068256, dt. 05.06.2018; Fatura nr. 069564/07, dt. 12.07.2018; Fatura nr. 069564, dt. 12.07.2018;

Fatura nr. 0070144, dt. 29.10.2018; Fatura nr. 0070144/11, dt. 01.11.2018; Fatura nr. 0073741/10, dt. 17.10.2019 ; Fatura nr. 0073781/V, dt. 11.03.2019; Fatura nr. 0073781/D, dt. 07.03.2019; Fatura nr. 0073781/2, dt. 04.02.2019; Fatura nr. 0073781, dt. 04.02.2019; Fatura nr. 0073676/1, dt. 28.06.2019; Fatura nr.0074787, dt. 05.11.2019; Fatura nr. 0074787/A, dt. 05.11.2019; Fatura nr. 0073781/A, dt. 07.02.2019; Fatura nr. 0073684/2, dt. 23.08.2019; Fatura nr. 0073684/1, dt. 13.08.2019; Fatura nr. 0073684, dt. 02.08.2019; Fatura nr. 0074787, dt. 05.11.2019; Fatura nr. 0074922, dt. 12.02.2020; Fatura nr. 0074922-b, dt. 24.02.2020; Fatura nr. 0074922-A, dt. 21.02.2020; Fatura nr. 0074922-C, dt. 27.02.2020 dhe Fatura nr. 0074874, dt. 13.11.2020, përkundër faktit se nuk janë përfshirë në parashkrim, pasi që propozimi për përmbarim ndaj këtyre faturave është paraqitur brenda afatit ligjor prej tre (3) vitesh nga neni 355 i LMD-së, të njëjtat nuk janë të përshtatshme për përmbarim dhe nuk paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit, kjo për faktin se nuk i përmblajnë elementet kumulative që kërkohen të plotësohen nga neni 29 par. 3 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”* kjo pasi që të njëjtat nuk janë pranuar me rregull nga debitori, kjo për faktin se asnjëra nga faturat nuk përmban vulën e pranimit të shkresave të debitorit si instiucion publik.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkalles se dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarimi është lejuar në bazë të faturave . nr. 60106/06, nr. 05814, nr. 058141, nr.058138/02, nr.058138-b/02; nr. 058194, nr.006145/8, nr.0583/02, nr.05134-A/02, nr.58134/02, nr.058138/ dhe fatura nr. 0060113 të cilat në kuptim të nenit 355 par 1 të LMD-së, janë përfshirë në parashkrim pasi që të njëjtat janë lëshuar në vitin 2017.

Gjykata e shkalles e dytë bazuar ne Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh qe *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura nr. 65728/02, dt. 06.02.2018, Fatura nr. 068256-1, dt. 20.06.2018; Fatura nr. 0065839/5, dt. 20.03.2018; Fatura nr. 0073739, dt. 12.07.2018; Fatura nr. 068256, dt. 05.06.2018; Fatura nr. 069564/07, dt. 12.07.2018; Fatura nr. 069564, dt. 12.07.2018; Fatura nr. 0070144, dt. 29.10.2018; Fatura nr. 0070144/11, dt. 01.11.2018; Fatura nr. 0073741/10, dt. 17.10.2019 ; Fatura nr. 0073781/V, dt. 11.03.2019; Fatura nr. 0073781/D, dt. 07.03.2019; Fatura nr. 0073781/2, dt. 04.02.2019; Fatura nr. 0073781, dt. 04.02.2019; Fatura nr. 0073676/1, dt. 28.06.2019; Fatura nr.0074787, dt. 05.11.2019; Fatura nr. 0074787/A, dt. 05.11.2019; Fatura nr. 0073781/A, dt. 07.02.2019; Fatura nr. 0073684/2, dt. 23.08.2019; Fatura nr. 0073684/1, dt. 13.08.2019; Fatura nr. 0073684, dt. 02.08.2019; Fatura nr. 0074787, dt. 05.11.2019; Fatura nr. 0074922, dt. 12.02.2020; Fatura nr. 0074922-b, dt. 24.02.2020; Fatura nr. 0074922-A, dt. 21.02.2020; Fatura nr. 0074922-C, dt. 27.02.2020 dhe Fatura nr. 0074874, dt. 13.11.2020 ne saje te cilave kreditori kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk ka prova se janë pranuar nga

debitori, të njëjtat nuk janë të vulosura nga debitori ne mënyrë që te konsiderohen si dokumente të besueshme. Po ashtu në shumicën prej faturave të lartcekurave, evidentohet përshkrimi “A.M.E – Komuna e Prishtinës”, andaj nuk dihet se faturat në fjalë a janë lëshuar për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent ashtu siç pretendon debitori, institucion ky krejtësisht i pavarur nga debitori, apo faturat në fjalë i janë referuar debitorit Komuna e Prishtinës.

Gjykata vlerësoi pretendimet e kreditorit por te njëjta mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Përndryshe në procedurën përmbartimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbartimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbartues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbartimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.Shk.II.nr.181/24, me datë 04.06.2024

Gjyqtari ,
Faton Bajrami